



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

C.nr.91/2018

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, si kontestimore e përberë nga Gjyqtari individual Faton Ademi, ne çështjen juridike te paditësit nga Mitrovica te cilin sipas autorizimit me shkrim e përfaqëson Av. nga Mitrovica, kundër te paditurës . , për shkak te kompensimit te ardhurave ne emër te shpërblimit jubilar dhe kompensimin te pagave përcjellëse për ne pension pas mbajtjes se seancës kryesore, me dt.02.11.2018 nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditësit nga Mitrovica dhe,

II.OBLIGOHET e paditura t'ia paguajë paditësit nga Mitrovica, ne emër te pagesës për shpërblim jubilar pas pensionimit si mësimdhënës te e paditura për 20 vjet e 3 muaj e 13 ditë te përvojës se punës ne vlerë te 75% te një page bazë, shumën prej 333.73 € dhe ne emër te 3 pagave përcjellëse për ne pension, shumen prej 1,334.94 €, respektivisht shuma totale prej 1,668.76 €, në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarrimit ligjor

III.OBLIGOHET e paditura t'ia paguajnë paditëses shpenzimet e procedurës në shumë prej 279 €, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarrimit ligjor.

IV.REFUZOHET E PA BAZUAR pjesa e kërkesëpadisë së paditësit nga Mitrovica, për kompensimin e 1 page e 25 % për shpërblim jubilar ne shumën prej 556.22 €.

A r s y e t i m

Paditësi përmes te autorizuarit te tij me datën 16.02.2018 ka ushtruar padi për kompensimin e te ardhurave personale pas pensionimit dhe atë ne emër te tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit dhe dy për shpërblimin jubilar ne shumën e përgjithshme prej 2,225.90 €.

Gjykata, me dt. 15.10.2018, ka caktuar seancë për shqyrtim përgatitore, në të cilën ka prezantuar i autorizuari i paditësit, si dhe përfaqësuesi i të paditurës.

I autorizuari i paditësit në seancë të shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare deklaroi se mbetem në tersi sipas padis dhe kërkesëpadisë, në fjalën përfundimtare i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë ta aprovoi të bazuar, shpenzimet e procedurës i kërkoi, ndërsa heqi dorë nga kamata.

Përfaqësuesi i të paditurës në seancë të shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare deklaroi se e kundërshtoj padinë dhe kërkesëpadinë mirëpo nuk e kundërshtoj nxjerrjen e provave

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, lidhur me çështjen konkrete juridike, referuar nenit 7 dhe 8 të LPK-së, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik nxori dhe administroi këto prova: Vendimi i dt.04.01.2018, shkresa e dt.07.02.2018, pasqyra e qarkullimit bankar në emër të paditësit për periudhën 01.11.2017-12.02.2018, vërtetimi i dt. 15.01.2018, kontrata e punës e dt.08.09.2015, dhe pas shqyrtimit bashkërisht gjitha këtyre provave gjykata konstatoi këtë gjendje:

Fillimisht paditësi para ngritjes së padisë ka drejtuar të paditurën me kërkesë të dt. 05.02.2018 për kompensimin e pagave jubilarë dhe përcjellëse pas pensionimit, ndërsa e paditura me datë 07.02.2018 e ka njoftuar paditësin se sipas Ligjit të Punës nuk janë paraparë kompensime të tilla, ndërsa dispozitat e Kontratës Kolektive nuk janë obligative për punëdhënësin, kjo vërtetohet nga përgjigja në kërkesë e dt.07.02.2018.

Nuk është kontestues fakti që paditësi ka qenë në marrëdhënie pune të e paditura si mësimdhënëse për më tepër se 20 vite, ky fakt u vërtetua nga vërtetimi i lëshuar nga Shkolla SHFMU "Fazli Greiçevci" i dt.15.01.2018.

Nuk është kontestues fakti se lartësia e pagës neto që paditësi e ka realizuar nga e paditura para pensionimit është shuma mujore prej 444.98 euro, ku kjo vërtetohet nga gjendja e llogarisë e datës 12.02.2018 për periudhën 27.11.2017 deri me 31.01.2018.

Nuk është kontestues se paditësit i ka pushuar marrëdhëniet e punës për shkak të plotësimi të kushteve për pension të pleqërisë, e kjo vërtetohet nga vendimi nr. _____, i dt. 04.01.2018.

Gjykata, lidhur me bazën e kërkesë padisë, iu referua nenit 35 par. 8 nën par. 8.2 të Kontratës Kolektive të Arsimit të dt.18.04.2017 e cila parasheh se

“punëtorët të cilët dalin në pension përfitojnë shpërblim jubilar për 20 vjet të parvojës në vlerë të 75% të një page bazë” dhe nenit 35.9 të po të njëjtës kontratë i cili parashihet se “punëtorët të cilët dalin në pension përfitojnë pagesë përcjellëse në lartësi të tri (3) pagave, sipas mesatares se tri pagave të fundit të punëtorit”.

Gjykata, lidhur me lartësinë e kërkesëpadiës, u referua në vlerën e tri pagave të fundit të paditësit e cila vërtetohet në bazë të pasqyrës bankare të dt. 12.02.2018, se paditësi ka marrë tri pagat e fundit në vlerë prej 444.98 € si dhe nenit 35 par. 8 nën par. 8.2, dhe nenit 35 par 9, të Kontratës Kolektive të Arsimit të dt.18.04.2017.

Prandaj, gjykata bazuar në nenit 35 par. 8 nën par. 8.2 dhe nenit 35 par 9 të Kontratës Kolektive të Arsimit të dt.18.04.2017 vendosi për kompensimin e shumës së përgjithshme prej 1,668.76 €, dhe atë në emër të tri pagave përcjellëse shumën prej 1,334.94€ dhe në emër të shpërblimit jubilar (75%një page bazë) shumën prej 333.73 €.

Sa i përket pjesës refuzuese të kërkesëpadiës, gjykata nuk e aprovoi në lartësinë e cekur si në kërkesëpadi nga ana e te autorizuarit te paditësit, pasi që Gjykata lidhur me vendosjen u bazua në Kontratës Kolektive te Arsimit të Kosovës, pasi që e njëjta është nënshkruar dhe ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe e rregullon këtë çështje në mënyrë specifike, ndërsa sa i përket bazës në Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive te datës 18.03.2014, me te cilën parashihet se “punëmarrësi i cili për 20 vjet radhazi dhe pandërprerë te parvojës se punës te punëdhënësi i fundit ti njihet e drejta ne shpërblim jubilar ne lartësia te dy pagave mujore te tij” gjykata nuk mund ta merr për bazë Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive për faktin se nëse dy ligje e rregullojnë të njëjtën situatë, ligji që rregullon një çështje specifike (lex specialis) anashkalon ligjin që rregullon vetëm çështjet e përgjithshme (lex generalis), pra në rastin konkret duhet te aplikohet Kontrata Kolektive e Arsimit të Kosovës e datës 18.04.2017 si ligj special.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara, i referohet shpenzimeve të përfaqësuesit të autorizuar të paditëses, për 1 seancë të mbajtur, në shumën prej 135 euro, 104 euro në emër te përpilimit te padis dhe 40 euro në emër te taksës për padi.

Gjykata aktgjykimin e saj e bazoi në nenin 143 par 1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

C.nr.91/2018 data 02.11.2018



UDHEZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, lejohet të drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimin të kësaj aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa ushtrohet përmes kësaj Gjykate